



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 02 prot.

Kamëz, më 19 01 .2021

V E N D I M

Nr. 02 Datë 19 .01 .2021

MBI

Propozim për miratimin e shumës financiare prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për familjen e shtetasit Z. Islam Kabashi .

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 19.01.2020 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.02 Datë 14.01.2021** , në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile, VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” V.K.B Kamez Nr. 60, datë 23.12.2019 “Për Miratimin e Buxhetit për vitet 2020, 2021 dhe 2022, struktura buxhetore: Gr0, Kap05, Progr. 03280, Art. 606, *Urdhërit të punës titullarit të bashkisë nr.22 dt.08.01.2021*” Për evidentimin, konstatimin si dhe vlerësimin e dëmeve si pasojë e reshjeve të shiut gjatë ditëve të para të Janarit 2021 **Këshilli Bashkiak Kamëz :**

V E N D O S I :

1. **Miratimin e shumës financiare prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, si ndihmë emergjente, nga buxheti i Bashkisë Kamëz sipas Prog 06180 Art 606 për shtetasin Islam Kabashi, banor i rrugës “ Bogovë” Valias, të cilit i është dëmtuar banesa nga reshjet e shumta të shiut gjatë ditëve të para të Janarit 2021.**
2. **Shuma 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr0, Kap05, Progr. 03280, Art. 606.**
3. **Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

K R Y E T A R E

MERITA PRENGA

